



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

---

### V E N D I M

#### PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJEVE TË DISA QV-VE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 27.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

### V E R E N

**Kzaz nr.12, Bashkia Lezhë,** në përmbushje të detyrës, ka kryer verifikimin e të gjithë ambienteve të qendrave të votimit, dhe për dhjetë objekte/ambiente ka konstatuar gjendje të papërshtatshme infrastrukturore dhe mungesë e kushteve të sigurisë. Në vlerësim të situatës i ka paraqitur KQZ-së kërkesë për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të tyre, duke bërë propozimet përkatëse për caktimin e vendndodhjeve të tyre.

**Kzaz nr.13, Bashkia Lezhë,** në përmbushje të detyrës, ka kryer verifikimin e të gjithë ambienteve të qendrave të votimit, dhe për nëntë objekte ka konstatuar gjendje të papërshtatshme infrastrukturore dhe mungesë e kushteve të sigurisë. Në vlerësim të situatës i ka paraqitur KQZ-së kërkesë për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të tyre, duke bërë propozimet përkatëse për caktimin e vendndodhjeve të tyre.



**Kzaz nr.53, Bashkia Prrenjas,** me shkresën nr. 12475, datë 27.06.2019, kërkon dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 2773, pasi Kinoklubi Prrenjas, ku është caktuar vendndodhja e kësaj QV-je nuk mund të përdoret me datë 30 qeshor 2019.

**Kryetari i Bashkisë Lushnjë,** me shkresën nr. 12390, datë 26.06.2019, kërkon dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 0398, caktuar në objekt privat në pronësi të shtetasit Namik Muçaj, për shkak të largimit të tij nga vendi.

**Kryetari i Bashkisë Belsh,** me shkresën nr. 12468, datë 27.06.2019, kërkon dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 2569, caktuar në objektin Vatra e Kulturës, për shkak të dëmtimit të tij, dëmtim I cili e bën të pamundur që ky objekt të funksionojë si Qendër Votimi.

**Prefekti i Qarkut Kukës,** me shkresën nr. 12470, datë 27.06.2019, në vlerësim të situatës dhe kërkesave të KZAZ nr. 9, Bashkia Tropojë, dhe KZAZ nr. 11, Bashkia Kukës, kërkon dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të 17 Qendrave të Votimit në Bashkinë Kukës, dhe dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të 5 Qendrave të Votimit në Bashkinë Tropojë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

### **V E N D O S I :**

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të QV-ve sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor nr. 9, nr. 11, nr. 12, nr. 13, nr. 45, nr.53, nr. 54, të publikojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, caktuar me këtë vendim.
3. Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore të njoftojë menjëherë zgjedhësit, për vendndodhjen e qendrës së votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>

